



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:036768

Datë: 04.08.2021

Numri i dokumentit: 02061370

PKR.nr.102/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje nga Kryetarja e Trupit Gjykes Medie Bytyçi, me bashkëpunëtorin profesional Lavdim Mehmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.B. nga P., për shkak të veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (me tej KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.nr.288/2020, të datës 26.02.2021, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar në prezencën e palëve: Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë Hivzi Bajraktari, të pandehurit L.B., e cila seancë ka qenë e hapur për publikun, e njëjta është regjistruar në procesverbal, në bazë të nenit 365 dhe 366 par.1 të KPPRK-së, me datë 02.08.2021 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 04.08.2021, e përpilojë me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

L.B. nga i ati R. dhe e ëma S., vajzërisë Ç. i lindur me datë -- në P., me vendbanim në rr."B.F.", ne P., me nr. personal --, i martuar, baba i tre fëmijëve, i pa pune, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 31.10.2020, rreth orës 20:40, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, në atë mënyrë që me datën e lartcekur, në rrugën e "xh." në P., Njësitë i patrullës derisa ka qene duke patrulluar në rrugën e lartcekur kanë hasur A.B. dhe M.Sh. duke u rrahur mes veti, ku pranë tyre ka qene edhe i pandehuri L.B. dhe policia me rastin e kontrollimit tek i pandehuri kanë gjetur dhe sekuestruar një armë të tipit "TT", prodhim kinez, me numër serik --, e kalibrit 7.62 mm dhe 5 fishek të kalibrit 7.62mm,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 3, 4, 7, 17,38 ,39, 40, 43, 69, 70 dhe 366 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 248 dhe 365 të KPPRK-së, të njëjtin:

E GJYKON

- I. Me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesë qind euro) €, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguajnë në afat prej 15 ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.
 - Në rast se nuk e paguan këtë gjobë atëherë e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të KPRK-së, duke iu përlllogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20 € (njëzet euro) dënim me gjobë.

- Dënimin e shqiptuar i pandehuri mund ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

I. OBLIGOHET i pandehuri, që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej njëzet (20 €) euro dhe shumë prej pesëdhjetë (50 €) euro, në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, ashtu që në tërësi shumë prej shtatëdhjetë (70 €) euro, obligohet të paguaj brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

II. Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, si dhe nenit 366 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nxjerr këtë:

URDHËR-URDHEROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve në vijim:

III. Arma e tipit "TT", prodhim kinez, me numër serik --, e kalibrit 7.62 mm dhe 5 fishek të kalibrit 7.62mm.

IV. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi Arma e tipit "TT", prodhim kinez, me numër serik --, e kalibrit 7.62 mm dhe 5 fishek të kalibrit 7.62mm, duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

V. Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

- *Aktakuza:*

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzën PP/L.nr.288/2020, të datës 26.02.2021, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndaj të pandehurit L.B., për shkak të veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht bazuar në nenin 282 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, si dhe nenit 366 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ka propozuar konfiskimin e Armës së tipit "TT", prodhim kinez, me numër serik --, e kalibrit 7.62 mm dhe 5 fishek të kalibrit 7.62mm.

- *Rrjedha e procedurës penale:*

Gjykata për këtë lëndë penale, në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, me datë 30.07.2021, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca ishte mbajtur në prezencën e palëve: Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë Hivzi Bajraktari dhe të pandehurit L.B.. Seanca e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale është mbajtur e hapur për publikun.

I pandehuri L.B., në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 30.07.2021, pas njoftimit nga Gjykata lidhur me të drejtën e tij, për këtë fazë të procedurës penale dhe pasi që u konfirmua se i njëjti e kupton aktakuzën dhe të drejtat, i pandehuri është deklaruar se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet dhe atë: për shkak të veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe ndër të tjera ka shtuar se: "*Se me vjen keq për këtë që ka ndodhur dhe shprehi keqardhje dhe pendim në këtë seance dhe i premtoj gjykatës ashtu siç i kam premtuar policisë dhe prokurorisë që në të ardhmen nuk do ta përsërisë një vepër të tillë penale, po ashtu i lutem gjykatës që ta merr parasysh gjendjen e dobët ekonomike dhe pendesën time dhe me rastin e marrjes së vendimit të me shqiptoj një dënim sa më të lehtë".*

Prokurori i rastit Hivzi Bajraktari në lidhje me deklarinimin mbi pranimin e fajësisë ndër të tjera ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga i akuzuari L.B., pasi që pranimi i fajësisë është bërë konform nenit 248 të KPPRK-se si dhe në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lendes, andaj i propozoj gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe njëkohësisht i propozoj gjykatës që me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ta merr si rrethane lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

- *Gjetjet e Gjykatës:*

Gjykata e ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i pandehuri L.B., e në mbështetje të nenit 248 par.4 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Po ashtu Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i datës 31.10.2021, deklarata e të pandehurit L.B., e dhënë në polici me datë 31.10.2021, foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera pjesë përbërëse të kësaj lëndë . Të gjitha këto shkresa dhe prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese e që në bazë të tyre dhe pranimin të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i njëjti ka kryer veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Gjykata i kishte tërhequr vërejtjen të pandehurit se pas pranimin të fajësisë nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën për ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësin e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj dënim më të butë. Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë prej të pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimit ka vërtetuar se i pandehuri L.B., është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (faktor) për veprën penale për të cilën akuzohet dhe atë: veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

- *Konfiskimi*

Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe 2 të KPP-së dhe nenit 366 par.3 KPRK-së, ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm, të përhershëm të armëve dhe atë: Arma e tipit "TT", prodhim kinez, me numër serik --, e kalibrit 7.62 mm dhe 5 fishek të kalibrit 7.62mm.

Gjykata rikujton se i pandehuri, se sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike, nga këto arsye gjykata ka vendosur ta konfiskoj përherë dhe atë të njëjtën ka urdhëruar që të shkatërrohet. Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të armës sipas nenit 366 par.3 të KPRK-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm, konfiskimi ishte propozuar në aktakuzë ndërsa dispozita e lartcekur e këtij Kodi, përcakton shprehimisht konfiskimin e detyrueshëm të tij.

- *Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit*

Me rastin e caktimit dhe individualizimin e dënimit, kjo Gjykatë mbështetur në rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit konform nenit 69 par.1, par.2 dhe par.3 të KPRK-së, mori në konsideratë minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale (*Në bazë të nenit 366 par.1 të KPRK-së, parashihet "Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet"*) si dhe faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë. Me rastin e vlerësimit dhe caktimit të dënimit, të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kjo Gjykatë në pajtim me rregullat e përgjithshme për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos u kufizuar vetëm në rrethanat e parapara me nenin 70 të KPRK-së.

Si rrethanë rënduese konform nenit 70 par.2 pika 2.1 të KPRK-së, ka marr në konsideratë shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar, e cila rezulton nga veprimet aktive të ndërmarra nga ana e të pandehurit. Nga shkresat e lëndës rezulton se i pandehuri L.B., armën e tipit "TT", prodhim kinez, me numër serik --, e kalibrit 7.62 mm dhe 5 fishek të kalibrit 7.62mm, i ka bartur me vete, fakt ky i cili gjen mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nga të cilat rezulton se të njëjtat, me rastin e konfiskimit, të pandehurit i janë gjetur në brez, gjë që tregon një shkallë të lartë të rrezikshmërisë.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese konform nenit 70 par.3 pika 3.11 të KPRK-së, Gjykata ka vlerësuar keqardhjen e shprehur nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 30.07.2021, i cili ka theksuar se:

“...Se me vjen keq për këtë që ka ndodhur dhe shprehi keqardhje dhe pendim në këtë seance dhe i premtoj gjykatës ashtu siç i kam premtuar policisë dhe prokurorisë që në të ardhmen nuk do ta përsërisë një vepër të tillë penale...” nga e cila rezulton se është penduar.

Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të pandehurin gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marr parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij dhe mundësia e pagesës me këste nuk do ta rrezikonte gjendjen materiale të të akuzuarit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht.

Gjykata, vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të pandehurit, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrethanat e tjera që kemi cekur, është adekuat dhe ne si gjykatë jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat e tjerë, që të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor konform nenit 450, par.2, pika 2.6, të KPRK-së. Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të Ligjit nr.05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga ajo që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.102/2021 dt.04.08.2021

Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja:
Medie Bytyçi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjyqimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjyqimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.